

Emigrimi dhe tregu i punës në Kosovë:

Potenciali i papërdorur
i fuqisë punëtore jo-aktive



Emigrimi dhe tregu i punës në
Kosovë: Potenciali i papërdorur
i fuqisë punëtore jo-aktive

Prill 2025

— **Përmbajtja**

Përmbledhje ekzekutive	4
1. Hyrje	5
2. Tregu aktual i punës dhe shkalla e aktivitetit ekonomik	8
3. Fuqia punëtore jo-aktive	9
4. Masat që duhen ndërmarrë për aktivizimin e fuqisë punëtore jo-aktive	13
5. Përfundimi	17
Shtojcat	19

Lista e shkurtesave

AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore
APRK	Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BP	Ballkani Perëndimor
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
NEET	Të rinjtë jashtë punësimit, arsimimit dhe trajnimeve
OBP	Organizata Botërore e Punës
OBZHE	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit

Përmbledhje ekzekutive

Tregu i punës në Kosovë do të sfidohet në vitet në vijim nga mungesa e fuqisë punëtore, kryesisht për shkak të emigrimit të qytetarëve dhe shkallës së lartë të fuqisë punëtore jo-aktive. Por, pa anashkaluar këtu edhe faktorin e plakjes dhe rënies graduale të numrit të popullsisë. Deri në vitin 2023, sipas të dhënave zyrtare, numri i personave që janë larguar nga Kosova drejt vendeve të ndryshme të botës ka arritur në 359 mijë persona, që përfaqëson rreth 22.6% të popullsisë së vendit. Në vitin 2023, shtetet e Bashkimit Evropian (BE-së) lëshuan 45,650 leje-qëndrime për qytetarët kosovarë, me Gjermaninë që dominon me 50% të totalit.

Një pjesë e personave të cilët po emigrojnë nga Kosova janë nga fuqia punëtore aktive, çka po ndikon në rritjen e kërkesës në vend për punëtorë vendas dhe të huaj. Në vitin 2024, Ministria e Punëve të Brendshme (MBP) në Kosovë lëshoi gjithsej 8,293 leje-qëndrime për shtetas të huaj, prej tyre, 3,974 për arsye të punësimit. Shumica e këtyre imigrantëve janë me origjinë nga shtetet e rajonit si Shqipëria, Serbia, Maqedonia e Veriut dhe vendet jashtë rajonit si Turqia, Bangladeshi, Filipinet dhe shtetet tjera të Azisë. Megjithatë, mbi gjysma e këtyre lejeve të lëshuara janë vazhdimësi e viteve paraprake. Pra, bilanci i emigrimit brenda vitit është konsiderueshëm më i lartë se i imigrimit, dhe si pasojë, punëtorët e huaj në Kosovë nuk mund të zëvendësojnë hendekun e mungesës së fuqisë punëtore që shkaktohet si rezultat i emigrimit.

Zgjidhja më e qëndrueshme për të adresuar mungesën e fuqisë punëtore në Kosovë është rritja e përfshirjes në treg e personave që i takojnë moshës së punës por që aktualisht nuk janë të punësuar apo duke kërkuar punë. Në Kosovë, shkalla e jo-aktivitetit është më e larta në Ballkanin Perëndimor. Të dhënat tregojnë se nga rreth 1 milion e 100 mijë persona të cilët i takojnë moshës së punës, vetëm 461 mijë persona apo 43% e tyre janë ekonomikisht aktivë, qoftë si të punësuar (89%) apo të papunësuar (11%). Ndërkaq, pjesa më e madhe, rreth 613 mijë persona apo 57% që i takojnë moshës së punës konsiderohen ekonomikisht jo-aktivë. Nga ta, 66% janë gra dhe 34% janë burra, që nënkupton se veçmas pjesëmarrja e ulët e grave në tregun e punës mbetet sfidë serioze. Pjesë e fuqisë punëtore jo-aktive janë edhe të rinjtë, të cilët nuk janë duke ndjekur arsim, punësim ose trajnime (NEET), shifra e të cilëve arrin në 78 mijë persona (30%), që është dukshëm më e lartë se mesatarja e BE-së (9.9%) dhe më e larta në Ballkanin Perëndimor.


Sektorët më të prekur nga mungesa e fuqisë punëtore janë ndërtimtaria, tregtia me shumicë dhe pakicë, gastronomia dhe hoteleria, dhe prodhimi, nga të cilët edhe tendenca për të emigruar është më e lartë. Shumica e pozitave të punës në këta sektorë nuk kërkojnë kualifikime të larta, por përfshijnë detyra të cilat mund të mësohen brenda një periudhe të shkurtër duke sugjeruar se fuqia jo-aktive vendore do të mund të plotësonte këto kërkesa.

Ky raport analizon dhe sjellë gjetje rreth asaj se si do të mund të bëhej një ndërlidhje në tregun e punës mes personave jo-aktivë dhe punëdhënësve, duke analizuar karakteristikat e personave jo-aktivë, kërkesën në treg sipas profileve, dhe sjellë rekomandime rreth reformave dhe trajnimeve të nevojshme që do të mundësonin përfshirje më të madhe në tregun e punës të fuqisë punëtore vendase si në periudhën afatshkurtër por edhe në atë afatgjatë.

1. Hyrje

Për vite me radhë, Kosova është përballur me shkallë të lartë të emigrimit, një fenomen i cili vazhdon të ndikojë ndjeshëm në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit. Të dhënat deri në vitin 2023 tregojnë se numri gjithsej i emigrantëve nga Kosova ka arritur në 359 mijë persona, që përbëjnë rreth 22.6% të gjithsej popullsisë së Kosovës.¹ Në anën tjetër, kategoria e imigrantëve ku përfshihen shtetasit kosovarë të kthyer si dhe të huajt që jetojnë në Kosovë është ekuivalent me 99 mijë persona apo 6.2% të gjithsej popullsisë.² Kjo reflekton dallimin e madh në mes të personave të cilët emigrojnë nga Kosova dhe personave të cilët imigrojnë drejt Kosovës. Trendi i emigrimit ka sjellë sfida të shumta dhe komplekse, ndër të cilat më e dukshme është ndryshimi në strukturën e fuqisë punëtore, një faktor që ndikon drejtpërdrejt në tregun e punës dhe potencialin për rritje ekonomike të vendit.³

Figura 1. Migrimi në Kosovë 2012 – 2023



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Demografia e personave të cilët janë të prirur për të emigruar përfshin kryesisht moshat e reja që janë kyçe për tregun e punës në vend.⁴ Po ashtu, sektorët nga të cilët personat e punësuar në Kosovë kryesisht emigrojnë, janë sektorë me produktivitet të lartë në ekonominë e Kosovës, ku përfshihen ndërtimtaria, prodhimi, tregtia dhe gastronomia.⁵ Për shembull, vetëm në sektorin e prodhimit, çdo punëtor kontribon me rreth 28,336 euro si vlerë e shtuar ekonomike në vend. Kjo reflekton ndikimin e përgjithshëm negativ ekonomik si rrjedhojë e largimit të punonjësve nga këta sektorë. Në anën tjetër, sfida në tregun e punës paraqet edhe emigrimi i personave të kualifikuar të punësuar në sektorë si kujdesi shëndetësor, edukimi, teknologjia e informimit dhe komunikimit dhe të tjera vitale për mirëqënien sociale dhe zhvillimin ekonomik të vendit.⁶

1 Kjo llogaritje është bazuar në matjen e re të popullsisë së Kosovës (1,602,515 banorë). Agjencia Kosovare e Statistikave (ASK), [Regjistrimi i popullsisë, 2024](#).

2 Ministria e Punëve të Brendshme, [Profili i migrimit](#), f.19, 2023.

3 Instituti GAP, [Prirja për të emigruar nga Kosova pas liberalizimit të vizave; ndikimi në fuqinë punëtore](#), f.4., 2024.

4 Po aty, f.12.

5 Po aty, f.14.

6 Instituti GAP, [Punësimi i Kosovarëve në Gjermani dhe Kosovë, sektorët dhe pagat sipas fuqisë blerëse](#), f.4., 2024.

Tabela 1. Prirja për të emigruar nga sektorët kryesorë ekonomikë dhe produktiviteti i tyre

2024	Numri i të punësuarve në Kosovë	Produktiviteti (në euro) ⁷	% që planifikojnë të emigrojnë
Tregti me shumicë dhe pakicë	84,154	17,525	18.1%
Bujqësi, pylltari dhe peshkim	11,505	61,935	2.6%
Prodhim	47,545	28,336	12.9%
Hoteleri dhe gastronomi	30,386	7,265	18.7%
Ndërtimtari	49,592	16,060	18.7%
Informim dhe komunikim	10,927	19,024	6.5%
Shëndetësi	19,993	11,214	7.1%
Edukim	38,485	8,576	7.1%
Transport dhe magazinim	13,541	34,171	3.2%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Anketa e GAP, llogaritjet e GAP

Shtetet e zhvilluara të Evropës ka kohë që po përballen me mungesë të fuqisë punëtore, që kryesisht i atribuohet plakjes së popullsisë dhe natalitetit të ulët.⁸ Për të adresuar këtë sfidë, reforma të ndryshme janë duke u zbatuar e një ndër të cilat është tërheqja e fuqisë punëtore të huaj.⁹ Këto reforma gjithmonë e më shumë po ndikojnë që Kosovës t'i largohen persona të cilët luajnë rol kyç në tregun vendor të punës. Sipas të dhënave të Eurostat, në vitin 2023 janë lëshuar gjithsej 45,650 leje-qëndrime për herë të parë për qytetarë të Kosovës nga shtetet e BE-së (Figura 1 në Shtojca).¹⁰ Nga këto leje-qëndrime dominon Gjermania (50%), ndjekur nga Sllovenia (14%), Kroacia (9%), Italia (8%), Zvicra (4%) e të tjera (Figura 2 në Shtojca).¹¹

Sektori privat në Kosovë, duke u përballur me sfidën e mungesës së punëtorëve brenda vendit, është fokusuar në tërheqjen e fuqisë punëtore të huaj. Marrëveshje të ndryshme kanë ndikuar që përveç personave nga shtetet e rajonit, në Kosovë të imigrojnë persona nga shtetet e largëta aziatike, për arsye punësimi. Sipas të dhënave më të fundit të MPB-së në Kosovë, numri i personave të huaj të cilët janë pajisur me leje-qëndrime në Kosovë në 2024 ishte 8,293, prej tyre, 4,273 apo rreth gjysma e lejeve janë lëshuar për arsye të punësimit, krahasuar me gjysmën tjetër që kanë për arsye bashkimin familjar, studimet, etj., (Figura 4 në Shtojca). Megjithatë, duke krahasuar vendimet për leje-qëndrime për herë të parë dhe ato si vazhdimësi, rezulton se çdo vit, numri i vendimeve për vazhdimësi është më i lartë.

⁷ Produktiviteti është llogaritur duke përdorur të dhënat e ASK-së për BPV-në e sektorëve përkatës (2024) dhe numrin e të punësuarve në ata sektorë (deri në TM2 2024).


⁸ Kennz, Ch., Yang, G., [Can Africa Help Europe Avoid Its Looming Aging Crisis?](#) Center for Global Development, Working Paper 584, 2021.

⁹ Disa nga reformat për të tërhequr imigrantë dhe mbushur hendekun në fuqi punëtore që Gjermania është duke implementuar përfshijnë: ngritjen e numrit të qytetarëve nga shtetet e Ballkanit Perëndimor nga 25 mijë në 50 mijë të cilët mund të pajisen me vizë punë; pajisjen me kartë të mundësive për të lejuar kërkimin e punës gjatë vizitës së përkohshme në Gjermani; zvogëlimin e viteve të pajisjes me pasaportë gjermane; ndër tjera. Instituti GAP, [Punësimi i Kosovarëve në Gjermani dhe Kosovë, sektorët dhe pagat sipas fuqisë blerëse](#), f.4., 2024.

¹⁰ Në këto të dhëna përfshihen edhe shtetet si Zvicra, Islanda, Danimarka dhe Lihtenshtajni të cilat nuk janë pjesë e BE-së.


¹¹ Për më shumë në lidhje me arsyet e emigrimit, shih Figuren 3 në Shtojca.

Figura 2. Numri i vendimeve për leje-qëndrime të përkohshme dhe përhershme në Kosovë 2021–2024



Burimi: Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)


Figura 3. Numri i vendimeve për herë të parë dhe në vazhdimësi për leje-qëndrime të përkohshme në Kosovë 2021–2024



Burimi: Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)

Shumica e imigrantëve në Kosovë vijnë nga shtetet e rajonit si Shqipëria, Serbia, Maqedonia e Veriut dhe vendet jashtë rajonit si Turqia, Bangladeshi dhe shtetet tjera të Azisë. Megjithatë, bilanci i emigrimit është konsiderueshëm më i lartë se i imigrimit, dhe si pasojë, punëtorët e huaj në Kosovë nuk mund të zëvendësojnë mungesën e fuqisë punëtore e cila krijohet si rezultat i hendekut të madh të shkaktuar nga emigrimi.

Figura 4. Origjina e personave të cilët u pajisën me leje-qëndrime në Kosovë 2024



Burimi: Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)


2. Tregu aktual i punës dhe shkalla e aktivitetit ekonomik

Sipas të dhënave të Organizatës Botërore të Punës (ang.ILO), rreth 39% e popullsisë së botës të cilët i takojnë moshës së punës janë jashtë tregut të punës. Për më tepër, mbi gjysma e grave në moshë pune në botë nuk janë pjesë e fuqisë punëtore aktive (52%), për dallim nga vetëm një e katërta e burrave në moshë pune në botë nuk ishin pjesë e fuqisë punëtore (25%), duke reflektuar mbi dallimet gjinore në pjesëmarrje në punë. Në shtetet anëtare të Organizatës Botërore për Zhvillim Ekonomik (OBZHE), sipas të dhënave më të fundit, shkalla e jo-aktivitetit ekonomik është mesatarisht 26%, ku përfshihen ShBA (25%), Britania e Madhe (21.7%), Zvicra (15.8%), Italia (33.4%), Gjermania (19.8%), Franca (25.2%), Austria (21.8%) dhe të tjera.¹² Në nivel global, 68% e qeverive e cilësojnë mungesën e fuqisë punëtore si arsye kryesore në draftimin e politikave të tyre të imigrimit.¹³

Megjithatë, sipas Këshillit të Bashkimit Evropian, për të adresuar kërkesën e paplotësuar për punë dhe aftësi, është i rëndësishëm angazhimi i personave të papunë.¹⁴ Bazuar në këtë, masat përkatëse duhet të synojnë mbështetjen e punëtorëve të punësuar me kohë të pjesshme, si dhe njerëzit joaktivë në moshë pune.¹⁵

Në Kosovë, të dhënat e fundit tregojnë se nga 1,074,704 persona të cilët i takojnë moshës së punës, 461,675 (43%) janë ekonomikisht aktivë në tregun e punës, krahasuar me 613,675 (57%) të cilët janë ekonomikisht jo-aktivë.

Figura 5. Shkalla e fuqisë punëtore aktive dhe jo-aktive, 2012–2024



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

¹² Organization for Economic Cooperation and Development (OECD) Data Explorer, [Intra-annual labour statistics. Inactivity rate](#), 2024.


¹³ United Nations (UN), [International Migration Policies](#). Department of Economic and Social Affairs, Population Division, f.3., 2017.

¹⁴ Masat tjera përfshijnë edhe grupe të veçanta që janë të nënpërfaqësura në tregun e punës, duke përfshirë ofrimin e mundësive për përmirësim dhe rikualifikim në fushat e nevojave të identifikuara të tregut të punës. Council of the European Union. [Labour and skills shortage in the EU: Mobilizing untapped labour potential in the European Union](#). Draft Council Conclusions, 15463/24., 2024.

¹⁵ Po aty.

Analiza e sektorëve ekonomikë sipas numrit të punësuarve tregon se sektori me më së shumti të punësuar është tregtia me shumicë dhe pakicë, ndjekur nga ndërtimtaria, prodhimi dhe arsimit (Tabela 1 në Shtojca). Nëse analizojmë punësimin sipas gjinisë, sektorët kyç si ndërtimtaria, transporti, bujqësia, pylltaria dhe peshkimi, prodhimi, dhe informimi dhe komunikimi janë sektorë të dominuar nga burrat si numër më i lartë i të punësuarve. Vetëm sektori i aktiviteteve të shëndetit njerëzor dhe punës sociale dominohet nga gratë.

Figura 6. Raporti i punësimit sipas gjinisë në sektorët kryesorë në Kosovë 2024 (TM2)




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

3. Fuqia punëtore jo-aktive

Nga gjithsej 613,029 persona jo-aktiv në treg të punës në Kosovë, 402,847 (66%) janë gra, ndërsa 210,182 (34%) janë burra. Kjo do të thotë se shkalla e jo-aktivitetit ekonomik tek gratë është për 32 pikë përqindje më e lartë se e burrave. Pra, fuqia punëtore jo-aktive dominon për vite me radhë në tregun e punës në vend.¹⁶ Në nivel botëror, Kosova radhitet e pesta për pjesëmarrjen më të ulët të grave në treg të punës, dhe e para në Evropë.¹⁷

Figura 7. Shkalla e fuqisë punëtore jo-aktive sipas gjinisë, 2012–2024



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

¹⁶ Agjencia e Statistikave të Kosovës. [Tregu i Punës: Anketa e Fuqisë Punëtore, 2023](#).

¹⁷ International Monetary Fund (IMF). [Republic of Kosovo, IMF Country Report No. 24/365](#), 2024

Marrë parasysh që gratë dominojnë në jo-aktivitetin ekonomik me 66%, disa nga sfidat që gratë hasin për të hyrë në treg të punës përfshijnë: detyrat e kujdesit për familjen, mungesën e kopshteve për fëmijë, mospërshtatjen në mes të aftësive të tyre dhe kërkesave të tregut të punës, mungesën e kontratave të punës formale, pagat e ulëta dhe hendekun gjinor të pagave, mungesën e kompensimit për orët e tepërta dhe punën praktike, mbështetjen e pamjaftueshme nga qeveria, frikën e humbjes së ndihmave sociale, mundësitë e kufizuara të transportit dhe tjera të ngjashme.¹⁸ Sipas të dhënave të fundit nga Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP) në Kosovë, niveli i papunësisë së grave është më i lartë se burrave për 8.7 pikë të përqindjes.¹⁹ Dallimet nga papunësia e grave në muajt e parë të vitit dhe muajt e fundit për më tepër tregojnë dekurajim dhe lëvizje drejt jo-aktivitetit.²⁰

Gratë të cilat jetojnë në zona rurale janë dyfish më të prirura të qëndrojnë ekonomikisht jo-aktive krahasuar me ato të cilat jetojnë në zona urbane.²¹ Sipas studimeve, në familjet të cilat pranojnë remitanca, pjesëmarrja në treg të punës është më e ulët, veçanërisht pjesëmarrja e grave.²² Ndikimi i remitancave në rritjen e pagës rezervë ndikon negativisht në ofertën e punës.^{23, 24} Bazuar në faktin se Kosova pranon vlerë të lartë të remitancave (1.35 miliardë në 2024),²⁵ ato ndikojnë ndjeshëm në sjelljen e tregut të punës duke siguruar një burim shtesë të të ardhurave familjare. Sipas të dhënave të ASK-së, remitancat janë burim kryesor i të hyrave për rreth 7% të ekonomive familjare.²⁶ Kjo siguri financiare u mundëson përfituesve të jenë më selektivë në kërkimin e punës dhe të qëndrojnë joaktivë në tregun e punës.²⁷

3.1 Kërkesa dhe oferta e tregut të punës

Ndërlidhja e faktorëve si shkalla e lartë e joaktivitetit ekonomik, shkalla e lartë e emigrimit dhe imigrimi i ulët, ndikojnë së bashku që shumë sektorë në Kosovë të sfidohen nga mungesa e shkathtësive dhe fuqisë punëtore. Sipas anketës së GAP-it,²⁸ sektorët kyç si ndërtimtaria, tregtia me shumicë dhe pakicë, gastronomia dhe hoteleria, si dhe prodhimi sfidohen më së shumti nga mungesa e fuqisë punëtore.

Nëse analizojmë në mënyrë më të detajuar të dhënat nga platforma më e madhe e punësimit në vend (KosovaJob) për vitin 2023 dhe 2024,²⁹ mbi 80% e të gjitha shpalljeve të punës kategorizohen në pozitat si në vijim: shitës/e, arkatar/e, kamarier/e, kuzhinier/e, shofer/e, dizajner/e grafike, zyrtarë/e të ndryshëm/me, agjentë/e të thirrjeve, asistentë/e të ndryshëm/me, menaxherë/e të ndryshëm, inxhinierë/e, praktikantë/e në fusha të ndryshme, depoist/e, ndër tjera (Figura 7).

Këto profile reflektojnë strukturën ekonomike të vendit tonë që ka një shkallë tejet

18 USAID Private-Sector Led Workforce Development Activity. [ICT Sector Overview. Workforce Demand and Supply. 2024.](#)

19 Niveli i papunësisë së burrave është 7.7% dhe i grave është 18.2%. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). [Anketa e Fuqisë Punëtore 2023.](#) f.15., 2024.

20 Gashi.A, Rizvanolli.A, Adnett.N, [Bucking the Trend: Female Labor Market Participation in Kosovo.](#) Vol.21. f.88-89, 2019.

21 Po aty.

22 United Nations Development Programme (UNDP). [Kosovo Remittance Study.](#)

23 Shair, W., et al., [The Differential Effect of Internal and External Remittances on Labor Participation and Employment Choices in Pakistan,](#) Google Scholar, Volume 14, Issue 3, 2024.

24 Në terma ekonomikë, paga e rezervuar përkufizohet si paga më e ulët me të cilën një individ është i gatshëm për të punuar. Torzewska.E.C., [Gender gap in reservation wages and the choice of education field.](#) Routledge Taylor&Francis Group, 2023.

25 Banka Qendrore e Kosovës (BQK). [Bilanci i pagesave, seritë kohore,](#) 2024.

26 Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). [Anketa e Buxhetit të Familjes.](#) 2022.

27 Chami. R., Ernst. E, et al., [Are Remittances Good for Labor Markets in LICs, MICs and Fragile States? Evidence from Cross-Country Data.](#) IMF Working Paper WP/18/102, 2018.

28 Në fund të vitit 2023, me qëllim të matjes së tendencës për të emigruar pas liberalizimit të vizave, Instituti GAP ka kryer një hulumtim të opinionit publik në nivel vendi duke përdorur teknikën e 'mostrës së shtresuar me përzgjedhje të rastësishme'. Janë anketuar gjithsej 1,066 qytetarë të Kosovës të moshës mbi 18 vjeç, me nivel të besueshmërisë 95% dhe me marzhë të gabimit +/-3%.

29 [kosovajob.com](#) është platforma më e madhe e punësimit në vend. Të dhënat e përdorura bazohen në rreth 12 mijë shpallje të vendeve të punës gjatë viteve 2023-2024.

të ulët të industrializimit. Në vendet e Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë Kosovën, matjet tregojnë se gati gjysma e punëtorëve janë të punësuar në vende pune të cilat nuk kërkojnë aftësi të shkrimit dhe leximit.³⁰ Kjo do të thotë që një pjesë e konsiderueshme e vendeve të punës në Kosovë kërkojnë kryesisht aftësi të ulëta. Ngjashëm, duke reflektuar mbi kërkesat për punë bazuar në KosovaJob, shumë prej pozitave nuk kërkojnë kualifikime dhe aftësi të specializuara, por përfshijnë detyra rutinore të cilat mund të mësohen brenda një periudhe të shkurtër. Kjo e bën më të lehtë qasjen në treg të punës për të rinjtë pa përvojë, personat e papunë afatgjatë si dhe gratë të cilat i takojnë moshës së punës por qëndrojnë jashtë tregut të punës.

Përgjithësisht, profesionet që kërkojnë më pak shkathtësi kanë edhe paga relativisht më të ulëta. Sipas të dhënave nga Administrata Tatimore në Kosovë (ATK), sektori i ndërtimitarisë në Kosovë ofron pagë mesatare mujore neto ekuivalent me 511 euro (572 euro bruto), sektori i tregtisë 491 euro (548 euro bruto), sektori i prodhimit 473 euro (527 euro bruto), sektori i hotelerisë dhe gastronomisë 348 euro (384 euro bruto).³¹ Bazuar në të dhënat paraprake të profilit të edukimit të fuqisë punëtore jo-aktive, mbi 70% e tyre kanë të përfunduar vetëm shkollimin fillor dhe të mesëm.

Tabela 2. Profesionet më të kërkuara në treg bazuar në shpalljet e KosovaJob për 2023–2024

Pozitat më të kërkuara në treg	Numri i shpalljeve të punës 2023–2024 (KosovaJob)
Shitës/e, sektorist/e, arkatar/e, etj.	1,846
Kamariet/e, kuzhinier/e, enëlarës/e, receptionist/e, etj.	1,200
Zyrtar/e dhe asistent/e, koordinator/e, rekrutues/e të ndryshëm/me, etj.	765
Kontabilist/e, analist/e kreditorë, auditor/e, economist/e, etj.	760
Agjent/e i/e thirrjeve, agjent/e për shitje, asistent/e virtual/e, etj.	688
Ekspert/e, konsulent/e, këshilltar/e, analist/e të ndryshëm, etj.	666
Vozitës/e, depoist/e, postier/e, asistent/e logjistike, etj.	649
Agjent/e marketingu, dizajner/e grafik/e, animator/e, krijues/e kontenti, etj.	451
Ekspert/e i/e IT-së, programer/e, specialist/e në teknologji, etj.	423
Elektricit/e, mekanik/e, monter/e, serviser/e, mjeshtër të ndryshëm, etj.	401
Menaxher/e departamenti, menaxher/e projekti, menaxher/e të përgjithshëm.	359
Inxhinier/e të elektrikës, inxhinier/e të makinerisë, inxhinier/e ndërtimi, etj.	287
Menaxher/e në shitje, menaxher/e dyqani, menaxher/e dege, etj.	256
Rrobaqepës/e, grimer/e, punëtorë/e të ndryshëm në shërbim, etj.	255
Mësimdhënës/e, edukator/e, mentor/e, etj.	231


Burimi: KosovaJob, llogaritjet e GAP

Në figurën më poshtë është bërë një ndërlidhje mes profesioneve kyçe të kërkuara aktualisht në treg sipas sektorëve dhe nivelit të edukimit të nevojitur për të kryer punët e tilla. Në rast se institucionet në Kosovë krijojnë programe trajnimesh, ri-aftësimi etj., të zërthyera më poshtë në këtë punim, do të mund të bëhej një përfshirje më e lehtë dhe e shpejtë e personave jo-aktivë në tregun e punës në periudhën afatshkurtër, si dhe do të kishim një përgatitje dhe përshtatje të tregut të punës edhe me trendet në shumë sektorë edhe për periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

³⁰ European Training Foundation (ETF). [Bridging the Skills GAP: Embracing Digital Transformation](#). 2025.

³¹ Të dhëna të siguruara nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) përmes kërkesës për të dhëna, maj 2024.

Figura 8. Disa nga profesionet më të kërkuara bazuar në platformën KosovaJob përshtatur me niveliet e edukimit, 2023–2024.



Burimi: KosovaJob, llogaritjet e GAP

4. Masat që duhen ndërmarrë për aktivizimin e fuqisë punëtore jo-aktive

Trajnime për avancimin e njohurive dhe përfshirjen më të lehtë në tregun e punës

Ofrimi i mundësive të trajnimeve të fokusuara adreson pengesat sistematike në veçanti për gratë dhe grup-moshat e reja. Duke marrë parasysh që pjesa më e madhe e grave të cilat janë jo-aktive në treg të punës kanë nivele më të ulëta të edukimit, si dhe sektorët të cilët janë më të sfiduarit nga mungesa e punëtorëve në Kosovë kërkojnë kryesisht aftësi praktike, siç tregon edhe Figura 8, është e rëndësishme të zhvillohen apo mbështeten programe trajnimi të cilat përgatisin të rinjtë e të rejat në orientim në tregun e punës. Programe të tilla kanë rezultuar të jenë efektive në vende tjera, drejt fuqizimit dhe pajisjes së të rinjve me aftësi të cilat nxisin pjesëmarrjen e tyre në punë dhe ndikojnë në rritje ekonomike gjithëpërfshirëse.³² Në Kosovë, trajnime të tilla do të ishin efektive veçmas për të rinjtë që aktualisht nuk janë në arsim, punësim ose trajnim.

Në anën tjetër, shumë prej kompanive nuk ofrojnë trajnime për përmirësim të aftësive të punonjësve, përfshirë këtu edhe punë praktike për të sapodiplomuarit. Andaj, krahas trajnimeve, është e rëndësishme që Qeveria të vazhdojë përkrahjen përmes subvencionimit të pagave, me qëllim të nxitjes së punëdhësve për të ofruar mundësi punësimi, veçanërisht për gratë, të rinjtë dhe personat që kanë qenë joaktivë për periudha të gjata. Kjo mund të realizohet duke vazhduar subvencionimin e pagave për punëdhënësit që kërkojnë individë të rinj, siç bëhet përmes programit Superpuna.³³

Mbështetje për rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës

Shkalla e lartë e grave në jo-aktivitet ekonomik thekson nevojën që politikat duhet të fokusohen në masë të madhe në integrimin e grave në tregun e punës dhe në lehtësimin e barrierave që i pengojnë ato të jenë aktive. Rritja e pjesëmarrjes së grave, sidomos në sektorët që përballen me mungesë të madhe të punëtorëve, do të kontribuonte drejtpërdrejt në rritjen e BPV-së së vendit.³⁴ Në mënyrë që Kosova të arrijë mesataren e Ballkanit Perëndimor (45%) të pjesëmarrjes së grave në treg të punës, do të duhej t'i shtoheshin rreth 180 mijë gra tregut të punës. Sipas një modeli të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) thuhet se "ndikimi në Bruto Produktin Vendor (BPV) do të llogaritej 22.9%, nga e cila, 19.3% si pasojë e mbylljes së hendekut të punësimit, 1.1% nga reduktimi i hendekut të orëve të punës, dhe 2.5% nga reduktimi i hendekut të pagesës."³⁵

Andaj, krahas trajnimeve për rritjen e shkathtësive, disa nga ndërhyrjet e nevojshme përfshijnë edhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit ditore për fëmijë të përballueshme dhe cilësore, meqë gratë për shkak të detyrimeve ndaj fëmijëve qëndrojnë jashtë tregut të punës. Ekziston një ndërlidhje direkte në mes të shërbimeve të kujdesit ditore dhe pjesëmarrjes së grave në treg të punës.³⁶ Një nga zotimet e qeverisë për të adresuar këtë shërbim ishte ndërtimi i 160 kopshteve të fëmijëve, por që për tri vite është realizuar ndërtimi i vetëm katër prej tyre.³⁷ Po ashtu, në Kosovë, përhapja e shkollave që funksionojnë me sistem

32 European Commission. [European Network of Public Employment Services](#). 2023. p.59.

33 Përmes programit Superpuna, qeveria mbështetë të rinjtë nga mosha 18-29 vjeç duke ndërmjetësuar midis tyre dhe punëdhënësve dhe subvencionuar 350 euro pagë në muaj për periudhë gjashtë mujore. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT). [Superpuna](#).

34 World Bank Group, [South Asia's Growth Outpaces Expectations, More Jobs for Women Needed to Unlock Full Potential](#), 2024.

35 International Monetary Fund (IMF). [Republic of Kosovo. Selected Issues](#). 2024

36 European Union. [Gender equality and work-life balance policies during and after the COVID-19 crisis](#). 2022.

37 Rreth 26 objekte të kopshteve të fëmijëve janë në ndërtim e sipër. Kosovo2.0. [Three Years of Kurti's Government](#).

me dy ose tri orare i ndërlikon më tej përpjekjet për të harmonizuar rolet e prindërve dhe punonjësve. Bazuar në përvojën e vendeve tjera, zgjatja e orarit shkollor së një ditë shkollore ka efekt pozitiv në pjesëmarrjen më të lartë të grave në tregun e punës.³⁸

Puna në distancë dhe mundësia për të punuar me orar të pjesshëm janë gjithashtu faktorë të rëndësishëm për balancimin në mes të punës dhe obligimeve familjare, veçanërisht për gratë. Historikisht, orari fleksibil i punës është përdorur për të ndihmuar gratë të kenë më shumë mundësi për t'u përfshirë në tregun e punës, duke u dhënë mundësinë për të menaxhuar më mirë përgjegjësitë e familjes dhe detyrat e shtëpisë. Kjo mbështetet edhe nga studimet empirike që tregojnë se ekziston një lidhje pozitive në mes të orarit fleksibil dhe aktivitetit ekonomik.³⁹

Në nivel ndërkombëtar, shtetet si Mbretëria e Bashkuar dhe Gjermania kanë një traditë të gjatë në përdorimin e orarit fleksibil dhe vazhdojnë të zbatojnë reforma të rëndësishme për të mbështetur gratë duke adresuar nevojat e tyre për më shumë mundësi për t'u përfshirë në tregun e punës pa pasur pengesë të drejtpërdrejt mes jetës profesionale dhe familjare.⁴⁰ Vendet të cilat janë përballur me emigrim të lartë dhe mungesë të fuqisë punëtore, si rrjedhojë, janë përpjekur të sjellin reforma të cilat nxisin pjesëmarrjen ekonomike. Në rastin e Meksikës, prezantimi i 'telework', në kuadër të Ligjit të Punës, ka ndikuar pozivisht në rritje të pjesëmarrjes të grave në treg të punës.⁴¹ Ngjashëm, Jordania ka miratuar një rregullore të veçantë që gratë të punojnë nga distanca, veçanërisht në pozitat administrative qeveritare dhe disa pozita të caktuara në sektorë privat. Qeveria ka promovuar gjithashtu orar fleksibel të punës për ta bërë më të lehtë për gratë të balancojnë përgjegjësitë e punës dhe familjes.⁴²

Megjithatë, në Kosovë, puna në distancë dhe orari fleksibil i punës është i kufizuar, duke kufizuar kështu edhe mundësitë për një balancim më të mirë mes jetës profesionale dhe asaj private për shumë punonjës/e. Nga fleksibiliteti përfitojnë si punëdhënësit, duke rritur produktivitetin, ashtu edhe punonjësit, veçanërisht gratë të cilat kryesisht qëndrojnë jashtë tregut të punës për shkak të mungesës së fleksibiliteti.⁴³

Rritje e pjesëmarrjes së të rinjve në tregun e punës

Një karakteristikë tjetër shqetësuese e tregut të punës në Kosovë është niveli i lartë i të rinjve jashtë punës.⁴⁴ Rreth 30% e personave të moshës 15 deri në 24 vjeç në Kosovë nuk janë në arsim, punësim ose trajnim (NEET).⁴⁵ Kosova ka normën më të lartë të pjesëmarrjes NEET krahasuar me vendet tjera të Ballkanit Perëndimor.⁴⁶ Ky nivel tejkalon mesataren në shtetet e BE-së me mbi 20% (Tabela 2 në Shtojca).⁴⁷ Kjo kategori përbën një pjesë të konsiderueshme të popullsisë rinore dhe përfaqëson një sfidë serioze për zhvillimin ekonomik të vendit. Për të adresuar këtë çështje, nevojiten politika efektive që promovojnë aktivizimin e të rinjve në tregun e punës dhe krijimin e mundësive për zhvillimin e tyre profesional.

[How is it going? 2024.](#)

38 Contreras,D.,Sepuleva.P.,[Effect of Lengthening the School Day on Mother's Labor Supply](#). World Bank Group. 2016.

39 Po aty.

40 Marazoitis.F, [Flexibility for equality: Examining the impact of flexible working time arrangements on women's convergence in working hours](#). *British Journal of Industrial Relations*, Volume 62, Issue 2, 2024.

41 World Bank Blogs. [Increasing Women's Workforce Participation in Mexico requires support for Child and Elder Care](#). 2024.

42 Qutteineh. H. [New Emploment Regime in Jordan](#). *Working Within Flexible Arrangements*. 2017.

43 Marazoitis.F, [Flexibility for equality: Examining the impact of flexible working time arrangements on women's convergence in working hours](#). *British Journal of Industrial Relations*, Volume 62, Issue 2, 2024.


44 European Union Kosovo. [Vocational Education and Training in Kosovo: Challenges and Opportunities](#). 2019.

45 UNICEF Kosovo Programme. [Annual Report 2023](#).

46 UNDP. [Youth Challenges and Perspective in Kosovo](#). 2021.

47 World Bank Group. [Share of youth not in education, employment of training, total \(% of youth population\)](#). 2020-2023.

Figura 9. Pjesëmarrja e të rinjve jo në arsim, punësim ose trajnime (NEET) në Kosovë, 2013–2024



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Shumë persona që i përkasin kategorisë NEET nuk kanë aftësitë dhe kualifikimet e nevojshme për të hyrë në tregun e punës. Programet e trajnimit profesional, të fokusuar në aftësitë që kërkohen nga sektorët me kërkesë të lartë, janë thelbësore. Përvoja praktike shpesh është një pengesë për personat, pjesë e NEET, dhe lidhja e tyre me mundësi praktike si punët praktike profesionale dhe stazhet në kompani lokale mund t'i ndihmojë ata të fitojnë eksperiencë të vlefshme pune. Trajnimet mund t'u mundësojë personave në NEET kalimin nga jo-aktiviteti në punësim direkt. Për të inkurajuar kompanitë të punësojnë këta persona, qeveria dhe autoritetet lokale duhet vazhdojnë të ofrojnë stimuj për bizneset që punësojnë të rinj që janë jo-aktivë në tregun e punës.⁴⁸

Zgjerimi i mundësive për mësim përmes punës do të ndikonte pozitivisht në përshtatjen e aftësive të individëve me kërkesat e tregut të punës, duke kontribuar në zvogëlimin gradual të hendekut midis aftësive të individëve dhe nevojave të tregut për punë.⁴⁹ NEET janë burim për ekonominë dhe mungesa e investimit në trajnime të tyre mund të rezultojë në kapital të humbur për tregun vendor të punës.⁵⁰

Forcimi i kapaciteteve dhe rolit të Agjencisë së Punësimit

Mungesa e njohurive për punë, një ndër arsyt tjera pse gratë janë jo-aktive në treg të punës, duhet të adresohet duke zgjeruar informacione në lidhje me vendet e lira të punës, në veçanti në sektorët ku kërkesa për punë është më e madhe. Rrjetet e ndryshme të mentorshipit do të ndikojnë që vajzat/gratë të motivoheshin për të punuar.⁵¹ Agjencia e Punësimit në Kosovë (APRK) vlerësohet se ndihmon bizneset në rekrutim, megjithatë, personat të cilët janë të interesuar të hynë në treg të punës deklarojnë që kjo agjenci duhet të informojë më shumë qytetarët dhe të krijojë më shumë shërbime të punësimit.⁵² Po ashtu, duhet të

48 Shembuj, [programi Superpuna](#), [programi i vetë-punësimit](#), etj.

49 Zyra e Kryeministrit. [Strategjia e Punësimit – Kosovë 2023–2027](#).

50 European Union Kosovo. [Vocational Education and Training in Kosovo: Challenges and Opportunities](#). f., 39. 2019.

51 Sahay, A., Rawlings, L., [How to increase women's economic participation?](#), World Bank Blogs, 2023.

52 UNDP. [Analysis of satisfaction for the provision of employment services for jobseekers and employers by the Employment Agency](#). Public Opinion on Kosovo Employment Agency Services. Final Report. 2020

zgjerohen kapacitetet e ofrimit të trajnimeve dhe organizimit të panairëve, pasi vlerësohet nga punëkërkuessit që këto shërbime nuk ofrohen mjaftueshëm.⁵³

Ndërlidhja e arsimit me tregun e punës

Përshtatja e nevojave të tregut të punës në Kosovë me kuadrot që dalin nga institucionet arsimore vazhdon të jetë dukuri sfiduese.⁵⁴ Studimet tregojnë se shumë kompani të rekrutimit në Kosovë hasin në vështirësi që kanë të bëjnë me aftësitë e pamjaftueshme të kandidatëve në raport me kualifikimet dhe përvojën që kërkohet. Sipas një ankete të punësimit, bizneset vlerësojnë dobët sistemin e edukimit në vend, pasi nuk mjafton në identifikimin e personave me aftësi të caktuara për punët që kërkohen në treg. Në nivel strategjik, aktualisht ndërveprimi në mes të nevojave të sektorit privat dhe sistemit arsimor në Kosovë është i pamjaftueshëm. Vetëm një pjesë e vogël e ndërmarrjeve të cilat janë në kontakt me institucionet arsimore ofrojnë rekomandime ose asistojnë në kurikulat shkollore.⁵⁵

Po ashtu, ndikimi i pandemisë, zhvillimit teknologjik dhe tranzicionit energjetik, kërkon performancë të përmirësuar të institucioneve arsimore,⁵⁶ pasi që rrezikohet të përkeqësohet gjendja e të papunësuarve dhe ulen mundësitë e të papunësuarve. Në nivel global rezultat i këtyre ndryshimeve, deri në vitin 2030, punëdhënësit presin që rreth 40% e aftësive bazë të punëtorëve të ndryshojnë.⁵⁷ Në veçanti, shtetet në zhvillim e sipër si Kosova do të ndikohen ende më shumë nga kjo nevojë për përmirësim/ndryshim të aftësive.

Mbështetje për teknologjitë inovative

Krahas sfidave të zakonshme me të cilat përballet Kosova në tregun e saj të punës, zhvillimi teknologjik ofron mundësi të mëdha për përmirësimin e situatës. Investimi në teknologji dhe aftësimin e të rinjve në fushat me potencial të madh, si ato të inteligjencës artificiale dhe zhvillimit të softuerëve, është shumë i rëndësishëm për të ardhmen e vendit. Kosova, me popullsinë e saj të re dhe të përgatitur për të adaptuar inovacione, ka mundësinë të zhvillojë sektorë që kërkojnë aftësi teknologjike të avancuara.⁵⁸

Zhvillimi i qëndrueshëm i teknologjisë mund të ndihmojë për të adresuar disa nga sfidat kryesore të tregut të punës, përfshirë papunësinë e të rinjve dhe mungesën e kuadrove të kualifikuara për disa industri. Rritja e produktivitetit dhe efikasitetit të ndërmarrjeve përmes përdorimit të teknologjive të reja mund të krijojë mundësi të reja punësimi, të cilat janë në përputhje me kërkesat e tregut vendorë.⁵⁹

Përkundër potencialit, Kosova qëndron ndër të fundit në teknologji në Ballkanin Perëndimor në dimensionin e politikave në lidhje me TIK.⁶⁰ Për të përfituar nga ky potencial, Kosova duhet të investojë më shumë në trajnime dhe edukim për teknologjitë e avancuara. Deri më tash, numërohen rreth 106 qendra të trajnimeve në fushën e teknologjisë në Kosovë, shumica e të cilave i takojnë sektorit privat.⁶¹ Mbështetja nga qeveria për sektorin e TIK ende nuk është e

⁵³ Po aty.

⁵⁴ Instituti GAP. [Analizë e shkurtër mbi mospërputhjen e arsimit dhe profesionit në Kosovë](#). 2020.

⁵⁵ World Bank Group. [Kosovo Country Report, Findings from the skills towards employment and productivity survey](#). p.17., 2019.

⁵⁶ European Training Foundation (EFT). [Skills Mismatch in EFT Partner Countries. Cross-Country Report](#). 2022.

⁵⁷ World Economic Forum. [Future of Jobs Report. Insight Report](#). 2025.

⁵⁸ OECD. [Job Creation and Local Economic Development](#), 2024.

⁵⁹ Po aty.

⁶⁰ OECD, [Western Balkans Competitiveness Outlook 2024. Kosovo](#). f.134., 2024.

⁶¹ USAID Private Sector-Led Workforce Development Activity. [ICT Sector Overview. Workforce demand and Supply](#). 2024.

mjaftueshme, gjë që kërkon ristrukturim të qasjes ndaj këtij sektori, në veçanti duke përgatitur të rinjtë përmes kurikulave të cilat përfshijnë zhvillimin e aftësive në TIK, ngritjen e kreativitetit, orientimin e të rinjve në këto fusha përmes bursave universitare dhe mbështetjen e trajnimeve në programe specifike të cilat mund të mbulojnë kërkesën e madhe në treg.⁶² Këto përpjekje do të ishin të rëndësishme për të krijuar mundësi për punësimin e të rinjve dhe për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Mbështetje për avancimin e shkathtësive në fushën e energjisë së pastër

Në anën tjetër, transformimi drejt energjisë së pastër dhe eficiente pritet që në të ardhmen të gjenerojë shumë vende të punës.⁶³ Energjia e pastër tashmë po luan rol të rëndësishëm në nxitjen e punësimit në nivel global. Në 2023, në vendet e BE-së, ShBA dhe Japoni, rreth 4–6% të rritjes së punësimit ishte rezultat i energjisë së pastër. Në Kinë, ndikimi ishte ende më i madh, pasi që energjia e pastër kontribuoi me 11% në rritjen e punësimit në këtë vit dhe ishte përgjegjëse për rreth 20% të rritjes së përgjithshme të BPV-së së vendit.⁶⁴ Sipas disa matjeve, deri në vitin 2030, tranzicioni drejt energjisë së pastër pritet të krijojë rreth 10.3 milionë vende të reja të punës në nivel global.⁶⁵ Në Kosovë, sipas një punimi të Insitutit GAP, në rast të zbatimit të plotë Strategjisë së Energjisë 2022–2031, vetëm përmes investimeve në efikasitet të energjisë mund të krijohen mbi 4 mijë vende të reja pune.

Megjithatë, rol të rëndësishëm në këtë transformim luan fuqia punëtore e kualifikuar. Arsimimi dhe trajnimet e duhura nuk ndikojnë vetëm në punësim, por luajnë rol kyç në arritjen e objektivave klimatike dhe në tranzicion më të lehtë drejt energjisë së pastër.⁶⁶ Kjo përfshin ofrimin e udhëzimeve profesionale, përshtatjen e mundësive të punës, mbrojtjen sociale dhe politikat aktive të tregut të punës për të rritur përshtatshmëri të aftësive me nevojat e tregut të punës.⁶⁷ Sipas studimeve, p.sh. në sektorin e energjisë solare, vetëm gjysma e pozitave të punës kërkojnë kualifikime universitare. Pjesa tjetër e pozitave kërkon aftësi të cilat mund të mësohen vetëm duke ndjekur trajnime profesionale.⁶⁸ Kjo kërkon përkrahje financiare dhe teknike nga institucionet në themelimin e qendrave të trajnimeve të fokusuara në zhvillim të aftësive për sektorin e energjisë.

62 Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), [Gjendja aktuale dhe potenciali i sektorit të shërbimeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit \(TIK-ut\) në Kosovë](#), 2022.

63 World Economic Forum. [How many jobs could the clean energy transition create?](#) 2022.

64 International Energy Agency (IEA). [World Energy Employment 2024](#), p.43.

65 Po aty.

66 International Renewable Energy Agency (IRENA). [Renewable Energy and Jobs. Annual Review](#). p.11., 2024.

67 Po aty., f.74.

68 International Renewable Energy Agency (IRENA). [Renewable Energy and Jobs. Annual Review](#). p.75., 2021.

5. Përfundimi

Kosova ka kohë që po përballet me të ashtuquajturën 'ikjen e trurit', fenomen i cili po ndikon në largimin e punonjësve nga sektorët kyç si shëndetësia, edukimi dhe TIK, duke shkaktuar mungesë të profesionistëve në këto fusha.⁶⁹ Për shembull, numri i qytetarëve të Kosovës të punësuar në sektorin e informimit dhe komunikimit në Gjermani është rritur mesatarisht 16% viteve të fundit, ndërsa paga mesatare është rreth 1.5 herë më e lartë se në Kosovë pasi përshtatet me koston e jetesës.⁷⁰ Adresimi i këtij fenomeni kërkon përshtatje të pagave dhe ofrim të kushteve më të favorshme të punës në Kosovë, në mënyrë që profesionistët të vazhdojnë kontributin e tyre brenda vendit. Po ashtu, është e domosdoshme të ofrohen udhëzime dhe nxitje për të rinjtë, të cilët duhet të orientohen në profesionet që ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik dhe janë thelbësore për mirëqenien afatgjatë të vendit.

Dukuria e emigrimit do të ndikojë në një mungesë të ndjeshme të fuqisë punëtore në vitet në vijim, sidomos në sektorë kyç dhe me produktivitet të lartë në ekonominë e vendit. Sipas të dhënave, nga gjithsej popullsia e cila i takon moshës së punës, 43% janë ekonomikisht aktivë, ndërsa 57% mbeten jo-aktivë, me gratë që përbëjnë 66% të kësaj kategorie.


Përballë këtyre sfidave, Kosova duhet të ndër marrë masa strategjike për të fuqizuar tregun e punës. Në veçanti, Kosova duhet të përqendrohet në mobilizimin e fuqisë punëtore brenda vendit. Prioritetet kryesore përfshijnë integrimin më të madh të grave në aktivitetet ekonomike, përmes eliminimit të barrierave që pengojnë pjesëmarrjen e tyre, si dhe krijimin e kushteve më të favorshme për përfshirjen e tyre në sektorë me mungesë të fuqisë punëtore. Po ashtu, të rinjtë duhet të trajnohen në përputhje me nevojat e tregut të punës, duke investuar në edukim dhe programe trajnimi që i përgatisin për sektorë që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik afatgjatë. Një rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet sektorëve me potencial të lartë për rritje, si teknologjia dhe energjia, që mund të luajë një rol kyç në transformimin e tregut të punës në Kosovë. Duke zbatuar këto reforma, Kosova ka mundësinë të lehtësojë sfidat aktuale dhe të ndërtojë një ekonomi gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

⁶⁹ Instituti GAP, [Punësimi i Kosovarëve në Gjermani dhe Kosovë, sektorët dhe pagat sipas fuqisë blerëse.](#)

⁷⁰ Po aty.


Shtojcat

Figura 1. Numri i leje-qëndrimeve të lëshuara për herë të parë nga BE për qytetarë të Kosovës, 2019 – 2023




Burimi: Eurostat

Figura 2. Numri i leje-qëndrimeve të lëshuara për herë të parë nga BE për qytetarë të Kosovës sipas shteteve, 2023




Burimi: Eurostat

Figura 3. Arsyet e pajisjes me leje-qëndrime të lëshuara për herë të parë nga BE për qytetarë të Kosovës sipas shteteve, 2014–2023




Burimi: Eurostat

Figura 4. Leje-qëndrimet e përkohshme për shtetasit e huaj në Kosovë, 2023 – 2024




Burimi: Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)

Figura 5. Shtetet kryesore të origjinës së personave të cilët u pajisen me leje-qëndrime të përkohshme në Kosovë, 2024




Burimi: Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)

Figura 6. Fuqia punëtore aktive, sipas gjinisë, 2012–2024 (TM2)




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Figura 7. Fuqia punëtore aktive, të punësuarit sipas gjinisë, 2012-2024 (TM2)



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Figura 8. Fuqia punëtore aktive, të papunësuarit sipas gjinisë, 2012-2024 (TM2)



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Tabela 1. Sektorët e të punësuarve në Kosovë sipas gjinisë, 2024 (TM2)

	Burra	Gra	Gjithsej
G – Tregti me shumicë dhe pakicë, riparime automjetesh dhe motoçikletash	59,200	24,954	84,154
F – Ndërtimtari	48,567	1,025	49,592
C – Prodhimi	36,745	10,800	47,545
P – Arsimi	18,519	19,966	38,485
O – Administrata publike dhe mbrojtja, sigurimi i detyrueshëm social	25,405	7,466	32,871
I – Aktivitete akomodimi dhe shërbimesh ushqimi	24,081	6,305	30,386
Q – Aktivitetet e shëndetit njerëzor dhe punës sociale	7,136	12,857	19,993
H – Transport dhe depozitim	11,387	2,154	13,541
N – Aktivitete administrative dhe shërbime mbështetëse	11,050	6,928	17,978
S – Aktivitete të shërbimeve të tjera	5,846	3,733	9,579
M – Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	8,627	3,858	12,485
J – Informim dhe komunikim	8,202	2,725	10,927
A – Bujqësi, pylltari dhe peshkim	10,607	898	11,505
K – Aktivitete financiare dhe sigurimesh	6,486	4,922	11,408
D – Furnizimi me elektricitet, gaz, avull dhe klimatizim	6,606	387	6,993
R – Arti, zbavitja dhe rekreacioni	2,080	1,062	3,142
U – Aktivitete të institucioneve dhe organizatave jashtë-territoriale	2,546	2026	4,572
E – Furnizimi me ujë, ujërat e zeza, menaxhim i mbetjeve	5,199	257	5,456
B – Minierat dhe xehroret	4,909	68	4,977
L – Aktivitete me prona të paluajtshme	933	0	933
T – Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës; aktivitete prodhuese të mallrave dhe shërbimeve të padiferencuara të ekonomive familjare për përdorim vetanak	364	558	922

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)


Tabela 2. Përqindja e të rinjve jo në arsim, punësim ose trajnime (NEET) në Bashkimin Evropian dhe Ballkanin Perëndimor, 2023

	2020	2021	2022	2023
Bashkimi Evropian	11.5%	11.2%	10.1%	9.9%
Shqipëria	26.90%	24.10%	23.70%	23.20%
Bosnja dhe Hercegovina	21.80%	19.30%	17.60%	16%
Maqedonia e Veriut	19.80%	18.30%	18.40%	19.10%
Mali i Zi	21.10%	20.70%	20.10%	/
Serbia	16.20%	16.70%	13.20%	12.40%
Kosova	33.50%	32%	32.90%	/

Burimi: Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO)



Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.



Instituti GAP përkrahët nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**



Sweden
Sverige




KCSF
FONDACIONI KOSQAR PËR SHQËRI CIVILE
KOSQAR CIVIL SOCIETY FOUNDATION



**Rockefeller
Brothers Fund**

Philanthropy for an Interdependent World



**Emigrimi dhe tregu
i punës në Kosovë:**
Potenciali i papërdorur
i fuqisë punëtore jo-aktive